

Për çfarë bëhet fjalë?

Rregullat për prodhimin, importin dhe përdorimin e substancave kimike në Bashkimin Evropian janë hartuar për të përmbushur nevojat e biznesit dhe të shoqërisë për substanca kimike më të sigurta.

Rregullorja "Mbi regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve" **REACH** ka për qëllim menaxhimin e rrezikut nga kimikatet, të nxisë konkurrueshmërinë dhe risitë gjatë proceseve të regjistrimit, vlerësimit, autorizimit dhe kufizimit të tyre.

Rregullorja "Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve" **CLP** lehtëson tregtinë globale dhe përmirëson sigurinë e punëtorëve dhe të konsumatorëve duke zbatuar sistemin e harmonizuar në shkallë globale të Kombeve të Bashkuara për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve në BE.

Këto rregulla krijojnë një sistem të përbashkët për të siguruar nivel të lartë mbrojtjeje për shëndetin e njeriut dhe mjedisin në BE.

Çfarë duhet të bëj?

Kjo varet nga roli që keni në zinxhirin e furnizimit, nga sa të rrezikshme janë lëndët që përdorni dhe si i përdorni ato.

Mjeti i Agjencisë Evropiane të Kimikateve (ECHA), i quajtur Navigator, ju vjen në ndihmë për të identifikuar rregullat që zbatohen për rastin tuaj.

<https://echa.europa.eu/identify-your-obligations>

Njihni kimikatet tuaja

Furnizoni me kimikate? - Duhet të merrni informacion për të klasifikuar, etiketuar dhe regjistruar substancat që prodhoni ose importoni si dhe të këshilloni klientët tuaj se si t'i përdorin këto substanca në mënyrë të sigurt.

<https://echa.europa.eu/regulations/reach/registration>
<https://echa.europa.eu/regulations/clp/understanding-clp>

Përdorni kimikate? - Duhet të zbatoni këshillat e dhëna nga furnitorët për menaxhimin e rrezikut ose t'i njoftoni ata kur këshillat janë të papërshtatshme.
<http://echa.europa.eu/downstream>

Kushtojni vëmendje "substancave me rrezikshmëri shumë të lartë"

Kimikatet më të rrezikshme janë renditur në listën e "substancave me rrezikshmëri shumë të lartë". Këto kimikate mund të shkaktojnë kancer, mund të dëmtojnë sistemet hormonale, mund të depozitohen në natyrë dhe në organizmat e gjalla dhe mund të shkaktojnë pasojë të pakthyeshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Lista rifreskohet dy herë në vit. Mund t'i shihni këtu:
<https://echa.europa.eu/candidate-list-table>

Në rast se substanca juaj është e përfshirë në listë, mund të zgjidhet për autorizim, gjë që do të thotë se do t'ju duhet të bëni kërkesë për autorizim që të vazhdoni ta përdorni.

Cilat janë kostot?

Rregullorja REACH kërkon që të paguhen detyrimet dhe tarifat për Agjencinë Evropiane të Kimikateve (ECHA). Sa më e vogël të jetë kompania juaj, aq më të ulëta janë detyrimet dhe tarifat. Mund t'i shihni këtu:

<https://echa.europa.eu/sme>

Kostot e tjera mund të jenë më të larta se tarifat. Ato varen nga detyrimet tuaja specifike, nga nevoja për të krijuar ose blerë të dhëna, nga zgjedhja juaj për të përdorur konsulentë ose nga nevoja/vendimi për të gjetur kimikate më të sigurta nga ato të rrezikshmet.

Ku të gjej informacion dhe ndihmë?

Përdorni faqen e internetit të ECHA-së si burim lajmesh, udhëzimesh, përgjigjet për pyetjet që mund të keni dhe për ndihmesë.

<https://echa.europa.eu/subscribe>

Terminologjinë ligjore dhe informacionet kyçe për shoqëritë private i gjeni në 23 gjuhët zyrtare të BE-së.


<https://echa-term.echa.europa.eu/>

Në faqen zyrtare të ECHA-së mund të kërkonit edhe informacione për vetitë, klasifikimin dhe përdorimin e kimikateve në tregun e BE-së.

Kontakti:

- Furnitorët dhe klientët tuaj për substanca ose produkte specifike;
- Organizatën e industrisë suaj për këshilla dhe informacion specifik për sektorin;
- Zyrën/Helpdeskun tuaj kombëtar për REACH dhe CLP në rast se keni pyetje për pajtueshmërinë me to;
- Zyrën e informacionit të ECHA-s për ndihmë lidhur me mjetet që duhet të përdorni.
<https://echa.europa.eu/support>

© istock



Çfarë do të thotë kjo?

Lëvizje e lirë e kimikateve

Për të gjitha shoqëritë private në BE zbatohen rregulla të njëjta.

Pa të dhëna nuk ka treg

Është i paligjshëm prodhimi, importi, tregtimi dhe përdorimi i substancave kimike të pargjistruara. Ky rregull vlen për substancat më vete ose përzierjet e tyre.

Komunikim në zinxhirin e furnizimit

Çdo aktor në zinxhirin e furnizimit (prodhues, importues, formulues, shpërndarës dhe shitës me pakicë) luan rol për të siguruar komunikimin e vetive të rrezikshme dhe përdorimin e sigurt të lëndëve kimike.

<https://echa.europa.eu/communication-in-the-supply-chain>

Konsumatorët kanë të drejtën të kërkojnë dhe marrin informacion nëse produktet e tyre përmbajnë substanca me rrezikshmëri shumë të lartë për shëndetin e tyre dhe mjedisin.

Fitoni avantazh në biznes

REACH dhe CLP janë projektuar për të nxitur zëvendësimin e kimikateve më të rrezikshme. Mund t'i ktheni detyrimet ligjore në mundësi biznesi duke iu larguar këtyre substancave që në fazë të hershme.

Bazuar në informacionin që keni për substancat që prodhoni, importoni ose përdorni, a mund të gjeni alternativa më të sigurta krahasuar me konkurrentët tuaj dhe të fitoni avantazh në biznes?

Përgjigjuni konsultimeve publike të ECHA-së nëse keni zhvilluar ose përdorur substanca alternative ndaj atyre me rrezikshmëri të lartë.

<https://echa.europa.eu/public-consultations>

A vlen kjo gjë edhe për biznesin tim?

Nëse shoqëria juaj:



Formuloni përzierje kimike?

p.sh. ngjyrues, vajra motori, sapunë dhe detergjente



Prodhoni ose importoni substanca kimike ose përzierje?

p.sh. aceton, fenol, bojëra, lubrifikantë



Prodhoni ose importoni artikuj konsumi?

p.sh. mobilie, veshje, pajisje elektrike



Përdorni kimikate?

p.sh. për riveshje ose pastrim

Në rast se përgjigja për çdonjërin prej këtyre pyetjeve është "Po", atëherë kjo fletëpalosje vlen për rastin tuaj.

Janë të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja në kuadrin e REACH dhe CLP, të cilat zbatohen për të gjithë sektorët industrialë dhe të gjitha shoqëritë që merren me kimikatet në Bashkimin Evropian, Islandë, Lihtenshtajn dhe Norvegji.

Respektimi i kërkesave ligjore do t'ju ndihmojë të menaxhoni rreziqet kimike në biznesin tuaj dhe të luani rolin tuaj në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

Do të jeni në gjendje t'u përgjigjeni pritshmërive të klientëve tuaj për kimikate dhe produkte më të sigurta, çka do të rrisë edhe emrin tuaj të mirë.

Filloni në: <https://echa.europa.eu/sme>

Siguria kimike dhe biznesi juaj

